



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 302/20
312/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “AREA” SH.P.K-Prishtinë si dhe ankesës së OE “REXHA SH.P.K&NOTI-BETON SH.P.K & DESHISHKU GB SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: “ARBOR GROUP SH.P.K & Euro Via SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit dhe zonave të degraduara të lumit Desivojcë-Komuna e Kamenicës”, me nr. të prok: “KM653-19-7914-5-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Kamenicë, më datën: 11.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “AREA” SH.P.K-Prishtinë, dhe ankesa e operatorit ekonomik: “REXHA SH.P.K&NOTI-BETON SH.P.K & DESHISHKU GB SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit dhe zonave të degraduara të lumit Desivojcë-Komuna e Kamenicës”, me nr. të prok: “KM653-19-7914-5-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Kamenicë.

II. VERTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit dhe zonave të degraduara të lumit Desivojcë-Komuna e Kamenicës”, me nr. të prok: “KM653-19-7914-5-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Kamenicës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “AREA” SH.P.K-Prishtinë, dhe ankesa e operatorit ekonomik ankues ekonomik “REXHA SH.P.K&NOTI-BETON SH.P.K & DESHISHKU GB SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “AREA” SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 15.05.2020 me nr. 302/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit dhe zonave të degraduara të lumit Desivojcë-Komuna e Kamenicës”, me nr. të prok: “KM653-19-7914-5-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Kamenicë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59, dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe Vendimi i OSHP-së nr. 971/19.

Operatori ekonomik ankues OE “REXHA SH.P.K&NOTI-BETON SH.P.K & DESHISHKU GB SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 18.05.2020 me nr. 312/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit dhe zonave të degraduara të lumit Desivojcë-Komuna e Kamenicës”, me nr. të prok: “KM653-19-7914-5-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Kamenicë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 10, 11, 56, 59 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.05.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 29.05.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1 ; Lidhur me pretendimin e OE ankues “Area” se AK nuk ka respektuar afatet ligjore pika 31 dhe 31.4 te RRUOPP sepse ka mbajtur në sirtar të vet lëndën e dosjes së tenderit të cilat kanë qenë pa validitet dhe pa sigurim të tenderit, duke pasur parasysh se nga data e hapjes së tenderit e deri në kërkesën e AK-së 21.04.2020 kur ka bërë kërkesën për OE konkurrues për vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të tenderit, kanë kaluar plotë 47 ditë që dokumentacioni dhe çmimet e ofruara nga OE konkurrues kanë qenë të pa afatëshme, duke përfshirë edhe kompaninë e shpallur fitues, OE “Arbor Group & Euro via”, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues nuk ka bërë vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të ofertave sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin sekondar për prokurim publik. Neni 31.4 i RRUOPP thotë: ‘Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre.

Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit.) Pra sipas kësaj dispozitë çartë përcaktohet se para skadimit të validitetit nga AK duhet ti dërgohet tenderuesve kërkesa për vazhdim të validitetit. Në rastin konkret AK nuk ka vepruar drejtë sepse për një kohë të gjatë ofertat e këtij tenderi kanë qenë të skaduar. Nuk mund të këtë pauza (ndërprerje) të afatit të validitetit të tenderit gjatë fazës së vlerësimit të tenderit. Arsyetimet e AK-së se është pritur miratimi i buxhetit, nuk është justifikim. Projekti duhet të iniciohet dhe të planifikohet me kohë dhe në përputhje edhe me rregullat financiare dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë siç parashihet në nenin 22 të LPP-së. Ky pretendim i OE ankues “Area” është kontradiktor me kërkesën përfundimtare në ankesë për Rivlerësim të këtij aktiviteti të prokurimit. Nëse ka shkelje nga AK gjatë procedurës siç është konstatuar në këtë rast nga OE ankesë që ofertat nuk kanë pasur validitet 47 ditë, kjo shkelje nuk mundet të riparohet me rivlerësim të ofertave. Si do që të jetë shkelja ka ndodhur nga AK në këtë rast. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2 ; Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se sipas autoriteti kontraktues nuk janë plotësuar kërkesat e FDT pika 9.1&9.2 pika 2. Lista e Projekteve, kontratat e përfunduara dhe kontratat që janë në ekzekutim (duke mos përfillur nenin 7 par 1,2 dhe 4 i LPP-së, lidhur me parimet bazike nga nenin 4.4 i RRUOPP. Pra AK nuk i pranon certifikatat e punëve që janë ekzekutuar dhe të pranuar nga institucionet e Kosovës, në këtë rast nga MAP-i si donator për projektin që është në ekzekutim me titullin “Ndërtimi i shkollës fillore në Pozharan” vlera e punimeve të pranuar është 636.304,05 posedon certifikatën e pranimit të punëve në bazë të kërkesave të kontratës saksisht neni 24 përfundimet dhe certifikatat e pranimit të punëve dhe nenit 25 llogaritja përfundimtare. Pjesa e II e kontratës kushtet e përgjithshme,

eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Lidhur me këtë pretendim ankimor në vendimin e OSHP-së nr. 971/19 është theksuar se AK duhet të kërkoj nga OE ankues në këtë rast "Area" sqarime shtesë në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-së lidhur me listën e projekteve të realizuar për plotësim të kërkesë 9.1&9.2 pika 2 të FDT-së. Gjatë rivlerësimit të ofertave AK në zbatim të vendimit të OSHP-së ka kërkuar sqarime shtesë nga OE "Area" për listën e projekteve të realizuara. OE ankues në përgjigje të AK-së për sqarime, ka ndryshuar listën fillestare të dorëzuar me ofertë duke reduktuar numrin e projekteve nga 15 në 11. Projekti i OE ankues që nuk është pranuar nga AK "Ndërtimi i shkollës fillore në Pozharan" është projekt i pa përfunduar.

Vlera e këtij projekti sipas kontratës që OE ka të ngarkuar në platformën elektronike me ofertë është 1.397.508,33 € dhe një Ankesë kontratë e lidhur me datë 04.11.2019 me MAP në vlerë prej 90.466,00 €. OE "Area" me ofertë ka dorëzuar një "Certifikatë të kompletimit të Punimeve-XIII". Kjo certifikatë është lëshuar nga Menaxheri i Kontratës për këtë projekt nga MAP-i për kryerje e pagesë së situacionit trembëdhjetë (XIII) por jo certifikatë e pranimi përfundimtarë të punimeve të realizuara për këtë projekt. Kërkesa e DT ka qenë "Procesverbalet e pranimi përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve në lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare deri në njoftimin për kontratë". Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

OE ankues "Rexha & KONTI-Betoni & Deshishku AG"

Përgjigje në Pretendimin nr. 1; Lidhur me pretendimin e OE ankues se arsyetimi i autoriteti kontraktues për eliminimin e tij me arsyetimin se gjoja nuk kemi vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit. Është e vërtetë se grupi i OE ankues nuk e ka vazhduar validitetin e sigurimit të tenderit siç është kërkuar me shkrim nga AK me shkakun e situatës së krijuar nga pandemia COVIT -19 ku procesi i vlerësimit nuk ka mundur që të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Autoriteti kontraktues ju ka dërguar kërkesë të gjithë tenderuesve me datën 21.04.2020 për vazhdimin e validitetit të ofertës. Tani edhe vetë OE ankues e pranon se nuk e ka bërë vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të ofertës sipas kërkesës së AK-së. Neni 35.5 i RRUOPP thotë "Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohej që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre". Sipas kësaj dispozite AK ka të drejtë të kërkoj zgjatje të validitetit të ofertave. Mirëpo neni 35.6 i RRUOPP thotë "Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apo jo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre". Sipas kësaj dispozite autoriteti kontraktues ka vepruar drejtë kur e ka eliminuar OE ankues në fjalë sepse OE ankues nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës.

Mendimi i OE ankues se ka qenë situatë e Pandemisë dhe nuk ka mundur të bëjë vazhdimin e validitetit nuk është justifikim sepse në rrethana të njëjta kanë qenë edhe operatorët e tjerë ekonomik që ju kanë përgjigjur

kërkesës së AK dhe kanë bërë vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të ofertës. Te njëjtën gjë ka mundur të bëjë edhe OE ankues në fjalë. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2, 3, 4 dhe 5 Lidhur me pretendimin e dytë dhe tretë të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë edhe OE “Teuta nuk e kanë plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit në piken 9.1&9.2 të FTD-se që ka të bëjë me menaxherin e projektit sepse këto kompani ka prezantuar për menaxher të projektit z.Arsim Rapuca respektivisht z. Salih Halili të cilët janë të angazhuar në punë primare në një institucion tjetër dhe të njëjtit nuk mundet të jenë të rregullte si menaxher të projektit në kontratën eventuale me autoritetin kontraktues sepse kjo është në kundërshtim me ligjin e punës.

Gjithashtu pretendimi i katër i OE ankues se AK nuk ka respektuar edhe nenin 10 dhe 11 të LPP-së për kufizimin në qasjen e dokumenteve të OE “Teuta” dhe pretendimi i pestë se me këtë rast është shkelur nga AK parimi i barazisë sipas nenit 7 të LPP-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Sipas kërkesës së AK të dhënë në dosjen e tenderit, OE i rekomanduar për kontratë dhe OE “Teuta” kanë ofruar kontratën e noterizuar për menaxher të projektit me inxhinjerin z.Arsim Rapuca respektivisht me z. Salih Halili të cilët kanë kualifikim përkatës dhe të njëjtit e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Nëse OE i rekomanduar për kontratë po OE “Teuta” do të lidhin kontratën me AK, atëherë është çështje e z.Rapuca dhe z. Halili mënyra e angazhimit në projekt si punë primare apo në punën tjetër që kanë atame institucione të tjera. E rëndësishme për AK është që OE në fjalë kanë ofruar kontratën me z. Rapuca dhe z. Halili sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Pra nuk qëndrojnë këto dy pretendime. Sa i përket pretendimit të katër të OE ankues se nuk i është dhënë qasja e mjaftueshme dhe nuk është bërë nga AK klasifikimi i dokumenteve të OE “Teuta” mendimi jonë është se OE ankues i ka marrë dokumentet e nevojshme gjatë qasjes në ofertën e OE “Teuta”. AK i ka dhënë hapësirën e nevojshme dhe kjo konfirmohet edhe me të dhënat që OE ankues i ka paraqitur në ankesë për ofertën e OE “Teuta”. Pra nga AK janë zbatuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Po ashtu nuk ka pasur diskriminim të asnjë operatori ekonomik siç e theksohet në pretendimin e pestë të OE ankues për shkelje të nenit 7 të LPP-së. Këto nuk qëndrojnë. Prandaj marrë në përgjithësi këto pretendime ankimore janë të pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Gjatë fazës së zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, pas pranimit vendimit të OSHP-së nr. 971/19 të datës 5 shkurt 2020 nga autoriteti kontraktues e deri me datën 21 prill 2020 të gjitha ofertat në këtë aktivitet të prokurimit kanë qenë të sakduara (pa validitet). Një ndërprerje e validitetit të ofertave për një kohë kaq të gjatë është në kundërshtim me nenin 31.4 i RRUOPP që rrjedhimisht është shkelej e nenit 57 të LPP-së sepse vazhdimi i validitetit duhet të kërkohej nga AK para datës së skadimit të tyre, e jo pas siç ka vepruar AK. OE ankues “Area” nuk i ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për realizimin e kontratave të kërkuara dhe është eliminuar me të drejtë nga ana e AK-së. Ndërsa konzorciumi

“Rexha” me të tjerët është eliminuar me të drejtë sepse nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertave sipas kërkesës së AK-së dhe njëherit mendojmë se nuk është palë e interesit sipas nenit 4.1.26 sepse nuk e ka vazhduar validitetin e ofertë dhe po ashtu ka operatorë të tjerë të përgjegjshëm me çmim më të ulët se oferta e tij. Si përfundim i shqyrtimit të kësaj lënde, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “Area” të Aprovohet pjesërisht ndërsa oferta e konzorciumit “Rexha” me të tjerët të refuzohet si e pa bazuar. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i shtratit dhe zonave të degraduara të lumit Desivojcë-Komuna e Kamenicës” me nr. prok. KM653-19-7914-5-1-1 ta Ritenderoj për shkak të mos vazhimit të validitetit të ofertave me kohë sipas dispozitave të nenin 31.4 i RRUOPP.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 01.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik -“AREA” SH.P.K-Prishtinë, me datë: 02.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik -“ REXHA SH.P.K&NOTI-BETON SH.P.K & DESHISHKU GB SH.P.K-Prishtinë, me datë: 02.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarament të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Area” se AK nuk ka respektuar afatet ligjore pika 31 dhe 31.4 të RRUOPP sepse ka mbajtur në sirtar të vet lëndën e dosjes së tenderit të cilat kanë qenë pa validitet dhe pa

sigurim të tenderit, duke pasur parasysh se nga data e hapjes së tenderit e deri në kërkesën e AK-së 21.04.2020 kur ka bërë kërkesën për OE konkurrues për vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të tenderit, kanë kaluar plotë 47 ditë që dokumentacioni dhe çmimet e ofruara nga OE konkurrues kanë qenë të pa afatëshme, duke përfshirë edhe kompaninë e shpallur fitues, OE “Arbor Group & Euro via”, paneli shqyrtues konform mendimit të dhënë nga eksperti shqyrtues profesional konstaton se Autoriteti kontraktues nuk ka bërë vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të ofertave sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin sekondar për prokurim publik. Neni 31.4 i RRUOPP thotë: ‘Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre.

Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit.) Pra, sipas kësaj dispozite çartë përcaktohet se para skadimit të validitetit nga AK duhet ti dërgohet tenderuesve kërkesa për vazhdim të validitetit. Në rastin konkret AK nuk ka vepruar drejtë sepse për një kohë të gjatë ofertat e këtij tenderi kanë qenë të skaduar. Mirëpo duke pasur parasysh situatën e krijuar me pandemi dhe vonesat në miratimin e buxhetit paneli shqyrtues vlerëson se kemi pasur të bëjmë me një situatë emergjente, dhe veprimi i AK-së edhe mund të arsyetohet.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se sipas autoriteti kontraktues nuk janë plotësuar kërkesat e FDT pika 9.1&9.2 pika 2. Lista e Projekteve, kontratat e përfunduara dhe kontratat që janë në ekzekutim (duke mos përfillur nenin 7 par 1,2 dhe 4 i LPP-së, lidhur me parimet bazike nga nenin 4.4 i RRUOPP. Pra, AK nuk i pranon certifikatat e punëve që janë ekzekutuar dhe të pranuar nga institucionet e Kosovës, në këtë rast nga MAP-i si donator për projektin që është në ekzekutim me titullin “Ndërtimi i shkollës fillore në Pozharan” vlera e punimeve të pranuar është 636.304,05 posedon certifikatën e pranimi të punëve në bazë të kërkesave të kontratës saktësisht neni 24 përfundimet dhe certifikatat e pranimi të punëve dhe nenit 25 llogaritja përfundimtare, pjesa e II e kontratës kushtet e përgjithshme. Paneli shqyrtues vlerëson se lidhur me këtë pretendim ankimor në vendimin e OSHP-së nr. 971/19 është theksuar se AK duhet të kërkoj nga OE ankues në këtë rast “Area” sqarime shtesë në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-së lidhur me listën e projekteve të realizuara për plotësim të kërkesës 9.1 & 9.2 pika 2 të FDT-së. Gjatë rivlerësimit të ofertave AK në zbatim të vendimit të OSHP-së ka kërkuar sqarime shtesë nga OE “Area” për listën e projekteve të realizuara. OE ankues në përgjigje të AK-së për sqarime, ka ndryshuar listën fillestare të dorëzuar me ofertë duke reduktuar numrin e projekteve nga 15 në 11. Projekti i OE ankues që nuk është pranuar nga AK “Ndërtimi i shkollës fillore në Pozharan” është projekt i pa përfunduar.

Vlera e këtij projekti sipas kontratës që OE ka të ngarkuar në platformën elektronike me ofertë është

1.397.508,33 € dhe një aneks kontratë e lidhur me datë 04.11.2019 me MAP në vlerë prej 90.466,00 €. OE "Area" me ofertë ka dorëzuar një "Certifikatë të kompletimit të Punimeve-XIII". Kjo certifikatë është lëshuar nga Menaxheri i Kontratës për këtë projekt nga MAP-i për kryerje e pagesë së situacionit trembëdhjetë (XIII) por jo certifikatë e pranimit përfundimtar të punimeve të realizuara për këtë projekt. Kërkesa e DT ka qenë "Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve në lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare deri në njoftimin për kontratë". Paneli shqyrtues konform sqarimeve të lartcekura, vlerëson se ky pretendim ankimor është i paqëndrueshëm për faktin se kemi të bëjmë me mosplotësim të kërkesës së dosjes së tenderit dhe kontratat e dorëzuara nga OE ankues le që nuk janë sipas kërkesës së natyrës së njëjtë, por as nuk e plotësojnë kërkesën e vlerës se kërkuar nga AK. Paneli shqyrtues sqaron se OE "Area" nuk ka referenca ne vlerën e kërkuar as te ndërtimit e lëre më sipas kërkesës se AK-se te natyrës se kontratës, rregullim te shtratit te lumit, andaj OE ankues është i papërgjegjshëm.

Në lidhje me pretendimet ankimore të OE të dytë ankues "Rexha & KONTI-Betoni & Deshishku AG", sa i përket pretendimit se arsyetimi i autoriteti kontraktues për eliminimin e tij me arsyetimin se gjoja nuk kemi vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit, ku sipas OE ankues është e vërtete se grupi i OE ankues nuk e ka vazhduar validitetin e sigurimit te tenderit siç është kërkuar me shkrim nga AK me shkakun e situatës se krijuar nga pandemia COVID -19 ku procesi i vlerësimit nuk ka mundur qe te finalizohet brenda afatit te periudhës se validitetit te tenderëve, paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ju ka dërguar kërkesë të gjithë tenderuesve me datën 21.04.2020 për vazhdimin e validitetit të ofertës. Tani edhe vetë OE ankues e pranon se nuk e ka bërë vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të ofertës sipas kërkesës së AK-së. Neni 35.5 i RRUOPP thotë "Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohej që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre". Sipas kësaj dispozite AK ka të drejtë të kërkoj zgjatje të validitetit të ofertave. Mirëpo neni 35.6 i RRUOPP thotë "Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apo jo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre". Sipas kësaj dispozite autoriteti kontraktues ka vepruar drejtë kur e ka eliminuar OE ankues në fjalë sepse OE ankues nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës dhe nuk iu është përgjigjur kërkesës për vazhdim të AK-së. Paneli shqyrtues poashtu konstaton se OE ankues "Rexha & KONTI-Betoni & Deshishku AG" është shumë më i lartë për nga çmimi se OE i rekomanduar për kontratë.

Lidhur me pretendimin e dytë dhe tretë te OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë edhe OE "Teuta nuk e kanë plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit në piken 9.1&9.2 te FTD-se që ka të bëjë me menaxherin e projektit sepse këto kompani ka prezantuar për menaxher të projektit z. Arsim Rapuca respektivisht z. Salih

Halili të cilët janë të angazhuar në punë primare në një institucion tjetër dhe të njëjtit nuk mundet të jenë të rregullte si menaxher të projektit në kontratën eventuale me autoritetin kontraktues sepse kjo është në kundërshtim me ligjin e punës.

Gjithashtu pretendimi i katër i OE ankues se AK nuk ka respektuar edhe nenin 10 dhe 11 të LPP-së për kufizimin në qasjen e dokumenteve të OE “Teuta” dhe pretendimi i pestë se me këtë rast është shkelur nga AK parimi i barazisë sipas nenit 7 të LPP-së, paneli shqyrtues konform mendimit të dhënë nga eksperti shqyrtues profesional, sqaron se sipas kërkesës së AK të dhënë në dosjen e tenderit, OE i rekomanduar për kontratë dhe OE “Teuta” kanë ofruar kontratën e noterizuar për menaxher të projektit me inxhinierin z. Arsim Rapuca respektivisht me z. Salih Halili të cilët kanë kualifikim përkatës dhe të njëjtit e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Nëse OE i rekomanduar për kontratë apo OE “Teuta” do të lidhin kontratën me AK, atëherë është çështje e z. Rapuca dhe z. Halili mënyra e angazhimit në projekt si punë primare apo në punën tjetër që kanë ata me institucione të tjera. E rëndësishme për AK është që OE në fjalë kanë ofruar kontratën me z. Rapuca dhe z. Halili sipas kërkesës së dosjes së tenderit, andaj këto dy pretendime të OE ankues janë të paqëndrueshme.

Sa i përket pretendimit të katër të OE ankues se nuk i është dhënë qasja e mjaftueshme dhe nuk është bërë nga AK klasifikimi i dokumenteve të OE “Teuta” mendimi jonë është se OE ankues i ka marrë dokumentet e nevojshme gjatë qasjes në ofertën e OE “Teuta”. AK i ka dhënë hapësirën e nevojshme dhe kjo konfirmohet edhe me të dhënat që OE ankues i ka paraqitur në ankesë për ofertën e OE “Teuta”. Pra, nga AK janë zbatuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Po ashtu nuk ka pasur diskriminim të asnjë operatori ekonomik siç e theksohet në pretendimin e pestë të OE ankues për shkelje të nenit 7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së kur OE ankues “Area” ka vlerësuar se nuk i ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për realizimin e kontratave të kërkuara dhe është eliminuar me të drejtë nga ana e AK-së. Paneli shqyrtues po ashtu vlerëson se konzorciumi “Rexha” me të tjerët është eliminuar me të drejtë sepse nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertave sipas kërkesës së AK-së dhe njëherit mendojmë se nuk është palë e interesit sipas nenit 4.1.26 sepse nuk e ka vazhduar validitetin e ofertë dhe po ashtu ka operatorë të tjerë të përgjegjshëm me çmim më të ulët se oferta e tij.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, duke rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik që ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim me të lire nga të gjithë ofertuesit e përgjegjshëm. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave i

është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kuvendi Komunal Kamenicë

1x1 OE -"AREA" SH.P.K-Prishtinë ;

1x1 OE "REXHA SH.P.K&NOTI-BETON SH.P.K & DESHISHKU GB SH.P.K-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.